

HIGH TACK



High Tack

Nr. art.
5893237151

Ngjyra
hiri

High Tack është ngjitës MS polimer, njëkomponentësh me performancë të lartë. Kombinon vetitë mekanike të ngjitësve poliuretani dhe silikonëve, duke e bërë një zgjidhje të shumëanshme dhe efektive për ngjitjen dhe izolimin e sipërfaqeve të ndryshme në ambiente të brendshme dhe të jashtme. Produkti ngurtësohet në kontakt me lagështinë e ajrit dhe siguron ngjitje fillestare shumë të fortë. I përshtatshëm për ngjitjen dhe izolimin e një game të gjerë materialesh ndërtimore.

Karakteristikat dhe avantazhet:

Aplikim i lehtë dhe praktik. Ngjitje fillestare jashtëzakonisht e fortë. Nuk përmban tretës ose izocianate. Rezistencë e shkëlqyer ndaj rrezeve UV, kushteve atmosferike dhe vjetërimit. Nuk krijon fluska. Ngjitje shumë e mirë në shumicën e materialeve pa përdorimin e primerit. Rezistencë e mirë ndaj ujit dhe kimikateve. Nuk shkakton korrozion në metale.

Fushat e aplikimit:

Ngjitja dhe izolimi i materialeve si metali, alumini, qelqi, plastika, druri dhe betoni. Ngjitja e materialeve të rënda. Izolimi i elementeve ndërtimore dhe të konstruksionit. Aplikime izoluese në kuzhina dhe banjo (aplikime për ngjitjen e pasqyrave dhe qelqit). Izolimi i sipërfaqeve prej guri natyror. Punime ndërtimi në ambiente të brendshme dhe të jashtme.

Nr. Art.	Emri	Sasia
5893237151	High tack superior	280 ml

Udhëzimet:

Para aplikimit, pritët maja e kartushit dhe vendoset gryka plastike (pipëza). Maja e grykës pritët sipas gjerësisë së sipërfaqes dhe vendoset në kartush. Aplikoni ngjitësin në formë vijash ose pikash mbi bazën ose mbi elementin që do të ngjitet. Vijat duhet të aplikohen në rreshta vertikale. Bashkoni pjesët që do të ngjiten sa më shpejt të jetë e mundur, maksimumi brenda 10 minutave (në varësi të temperaturës dhe lagështisë relative). Gjatë kësaj kohe, pjesët mund të rregullohen ndërsa në fund duhet të shtypen mirë ose të goditen lehtë me një çekan gome. Ngjitësi i tepërt përgjatë skajeve mund të hiqet me një shpatullë/skalper. Mbetjet e ngjitësit që ende nuk janë tharë mund të hiqen me alkool. Ngjitësi i tharë duhet të hiqet mekanikisht. Raporti gjërësi/thellësi i lidhjes duhet të jetë 2:1.

Magazinimi dhe afati i skadimit

Të mbrohet nga uji, ngricat dhe kushtet e pafavorshme të motit. Ruani në vend të thatë dhe të freskët në paleta druri në temperaturë +5 °C deri +25 °C, në vende pa lagështi. Afati i skadimit është 12 muaj, me kusht që të respektohen kushtet e mësipërme të magazinimit.